



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 109, Datë 27.03.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE
SHQIPTARE (KESH) SH.A.”, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA TEC-I LUNDRUES I INSTALUAR NË PORTIN E TRIPORTIT NË
GJIRIN E VLORËS

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 308/11 prot., datë 24.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 350, datë 28.12.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.”, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-i lundrues, i instaluar në Portin e Triportit në Gjirin e Vlorës, i përbërë nga dy gjenerues Tigri 1 dhe Tigri 3, për një afat 2 (dy) vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.12.2022 dhe 31.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.01.2023, periudha e pritjes së komenteve është 30 ditë pasi TEC është i lidhur në OST), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 55, datë 24.02.2023, vendosi të zgjasë me 30 ditë vendimmarrjen e tij në lidhje me licencimin e shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike

Shqiptare”(KESH) sh.a., pasi u konstatua se shoqëria dokumentoi në ERE se ishte pajisur me miratimin paraprak të pikës së lidhjes e ishte në proces për miratimin e marrëveshjes së lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe kishte aplikuar për marrjen e lejes së përdorimit të burimit ujqor.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 350/2022 me shkresën nr. 2074/3 prot., datë 30.12.2022, dhe e ka kujtuar për plotësimin e dokumentacionit të munguar, me shkresën me nr. 308/2 prot., datë 07.01.2023. KESH sh.a. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën nr. 308/1 prot., datë 01.02.2023, nr. 308/6 prot., datë 24.02.2023, nr. 308/9 prot., datë 20.03.2023, dhe nr. 308/10 prot., datë 24.03.2023.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria KESH sh.a. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Në kuadër të mbikëqyrjes dhe zbatimit të kushteve të licencës, shoqëria të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe vitit 2021, brenda datës 31.07.2023.
- Në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se kontrata e qirasë për prodhimin e energjisë elektrike nga impianti termik Tigër 1 dhe Tigër 3, është nënshkruar për një periudhë 2 (dy) vjeçare, duke filluar ky afat nga data e komisionimit të veprës, pra kur asetet bëhen operacionale, ERE do të kushtozohet nga ky afat në përcaktimin e vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.” në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-i lundruer i instaluar në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 2-vjeçar, duke filluar nga data e komisionimit të veprës, të përbërë nga dy gjenerues:
 - a) “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW.
 - b) “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI